

**Shoqëria Administruese
“Credins Invest” Sh.a.**

**Pasqyrat Financiare për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(me Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i audituesve të pavarur	
Pasqyra financiare:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse	2
Pasqyra e flukseve monetare	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Shënime për pasqyrat financiare	5 - 33

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërise administruese të fondeve "Credins invest" Sh.a.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese të fondeve "Credins Invest" Sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital si edhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë Administruese të fondeve "Credins Invest" Sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e Tjera të Shoqërisë për vitin 2024 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 24 shkurt 2025



Shoqëria Administruese "Credins Invest" Sh.a
Pasqyra e pozicionit financiar
(në Lek)


AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	7	15,004,520	3,924,827
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	8	43,115,248	39,971,505
Investime në letra me vlerë me KA	9	52,093,416	52,107,628
Të arkëtueshme nga Fondet	10	8,140,553	6,460,300
Aktive me të drejtë përdorimi	11	7,173,967	7,974,541
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	12	2,266,905	1,527,791
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	13	6,139,728	7,623,497
Tatim fitimi i parapaguar		-	273,687
Aktive të tjera	14	508,395	396,583
TOTAL AKTIVE		134,442,732	120,260,359
DETYRIME			
Detyrime të tjera	15	4,458,684	7,052,682
Detyrime të qirasë	11	6,608,832	7,048,207
TOTAL DETYRIME		11,067,516	14,100,889
KAPITALI			
Kapitali i paguar	16	95,822,394	95,822,394
Rezerva ligjore	16	10,000,000	10,000,000
Fitim i mbartur	16	17,552,822	337,076
TOTAL KAPITALI		123,375,216	106,159,470
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIME		134,442,732	120,260,359

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Shoqërisë Administruese "Credins Invest" më datë 27 Janar 2025 dhe u firmosën në emër të tyre nga:

Estela Koçi
Drejtore Ekzekutive



Armira Çitozi
Drejtore Finance



Pasqyra e pozicioni financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse

(në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura			
Tarifa nga administrimi Fondeve	17	71,341,373	61,871,006
Tarifa nga tërheqjet e parakohshme	18	3,171,481	5,398,475
Të ardhura/(shpenzime) interesi, neto	19	2,166,935	2,995,808
Të ardhura/humbje nga investimet në kuota	20	3,143,743	(28,495)
Të tjera		1,666	3,333
Total të ardhura		79,825,198	70,240,127
Shpenzime Personeli	21	(37,249,478)	(35,475,521)
Amortizim dhe zhvlerësim	11,12,13	(5,701,101)	(5,620,063)
Shpenzime administrative	22	(16,610,191)	(14,260,157)
Total shpenzime		(59,560,770)	(55,355,741)
Fitime nga kursi kembimit, neto		195,890	980,888
Total fitime nga kursi këmbimit, neto		195,890	980,888
Fitimi para tatimit		20,460,318	15,865,274
Shpenzimi për tatim fitimin	23	(3,244,572)	(2,530,071)
Fitimi për periudhën		17,215,746	13,335,203
Të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Total të ardhurave gjithpërfshirëse për periudhën		17,215,746	13,335,203

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Pasqyra e flukseve monetare

(në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
<i>Flukset monetare nga aktivitetet operative</i>			
Fitimi për periudhën		17,215,746	15,865,274
<i>Rregullime për:</i>			-
Amortizim dhe zhvlerësim	11,12,13	5,701,101	5,620,063
Të ardhura/shpenzime interesi, neto		(2,168,601)	(2,999,141)
Të ardhura interesi nga njësitë e investimit	20	(3,143,743)	28,495
Të ardhura nga tarifa e administrimit dhe penalitetet	17,18	(74,512,854)	(67,269,481)
<i>Ndryshime në:</i>			
Aktive të tjera		20,449	125,106
Detyrime të tjera		(3,269,414)	3,161,022
Interes i arketuar		2,807,300	1,910,762
Të ardhura nga tarifa e administrimit dhe penalitetet		76,193,107	67,303,097
Tatim fitimi i paguar		(2,242,424)	(1,461,208)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		16,600,667	22,283,989
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve të trupezuara dhe të patrupëzuara		(1,369,462)	(4,164,783)
Maturim depozite		-	-
Maturim bono		-	40,000,000
Investime në njësi		-	(40,000,000)
Shitje e investimeve në njësi		-	-
Blerje e letrave me vlere		-	(28,205,327)
Flukset monetare neto (të përdorura në) nga aktivitetet operative		(1,369,462)	(32,370,110)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Divident i paguar		-	(2,681,010)
Pagesë e detyrimeve të qirasë		(4,151,512)	(4,787,019)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese		(4,151,512)	(7,468,029)
Rritje/(rënia) neto në flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre		11,079,693	(17,554,150)
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre me 1 janar		3,924,827	21,478,977
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre me 31 dhjetor	7	15,004,520	3,924,827

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Pasqyra e ndryshimeve në kapital
(në Lek)

	Kapital i paguar	Rezerva ligjore	Humbje e mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2023	95,822,394	10,000,000	(10,317,117)	95,505,277
Fitimi i periudhës	-	-	13,335,203	13,335,203
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	13,335,203	13,335,203
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Kontribute dhe Shpërndarje				
Dividendët	-	-	(2,681,010)	(2,681,010)
Transaksione totale me pronarët e Shoqërisë			(2,681,010)	(2,681,010)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	95,822,394	10,000,000	337,076	106,159,470
Gjendja më 1 janar 2024	95,822,394	10,000,000	337,076	106,159,470
Fitimi i periudhës	-	-	17,215,746	17,215,746
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	17,215,746	17,215,746
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Kontribute dhe Shpërndarje				
Dividendët	-	-	-	-
Transaksione totale me pronarët e Shoqërisë	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	95,822,394	10,000,000	17,552,822	123,375,216

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. ENTITETI RAPORTUES

“Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve (në vijim “Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 34260, më datë 31.10.2005 dhe me seli në Rugën “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë.

Shoqëria fillimisht u liçencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më datë 23 nëntor 2011, me licencën nr. 3, për të vepruar si Shoqëri Administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit sipas Ligji Nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Më 30.05.2016, Shoqëria u pajis me liçencën nr. 3, për të administruar aktivet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, krahas veprimtarisë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar. Emri i Shoqërisë u ndryshua në “Credins Invest” sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Shoqëria ka në administrim një fond pensioni vullnetar, me emrin “Credins Pension” miratuar më 13 dhjetor 2011 me vendimin Nr. 173 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; dhe një fond investimi me emrin “Credins Premium”, miratuar më 30 maj 2016 me vendimin Nr. 85 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit ka filluar veprimtarinë e tij më 1 korrik 2016. Banka Depozitare e Fondit të Pensionit është Banka e Tiranës sh.a., miratuar me Vendimin Nr.91, datë 18 Korrik 2012, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Banka Depozitare e Fondit “Credins Premium” është Banka Amerikane e Investimeve sh.a., miratuar me Vendimin Nr.2, datë 31 Janar 2018, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese e Fondeve “Credins Invest” sh.a., u licensua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr.206 datë 29.12.2020 për miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe Vendimin nr.207 datë 29.12.2020 për licensimin e shoqërisë “Credins Invest” si Shoqëri Administruese e Fondeve të investimeve alternative që ofron fonde të investimeve alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Fondi i investimeve alternative Sea Land - Shoqëri Komandite SIK është miratuar me Vendimin nr. 57 datë 26.03.2021 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një fond për investime alternative në formën e shoqërisë komandite ofruar për klientët profesionistë dhe të kualifikuar në përputhje me ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Fondi u krijua nga një investitor profesionist, Credins Bank sh.a. dhe një investitor i kualifikuar Z.Renis Tërshana. Fondi është regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar në 9 dhjetor 2020. Banka Depozitare e Fondit është Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

Fondi i investimeve alternative Green View - Shoqëri Komandite SIK është miratuar me Vendimin nr. 241 datë 29.12.2021 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një fond për investime alternative në formën e shoqërisë komandite ofruar për klientët profesionistë dhe të kualifikuar në përputhje me ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Fondi u krijua nga një investitor profesionist Credins Bank sh.a dhe një investitor i kualifikuar Z.Arjan Hana. Fondi u regjistrua në Regjistrin Tregtar shqiptar më 21.10.2021. Banka Depozitare e Fondit është Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

Me vendimin Nr 127 ne daten 31.07.2024, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi regjistrimin e Fondit “Credins Optimal”, fond investimi alternativ i cili u ofrohet klienteve profesional edhe te kualifikuar.

Me vendimin Nr 194 ne daten 01.11.2024, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi regjistrimin e Fondit “Credins Global Bonds”, fond investimi alternativ i cili u ofrohet klientve profesional edhe te kualifikuar.

Me Vendimin nr.2 datë 29.05.2024 të Asamblesë së Aksionarëve u miratua ndryshimi i emrit të Shoqërisë në “Credins Invest sh.a.– Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”.

Informacion mbi strukturën e Shoqërisë është dhënë në shënimin 16.

(në Lek)

1. ENTITETI RAPORTUES (VAZHDIM)

Si rezultat i ndryshimeve ligjore, konkretisht miratimi i ligjit nr. 76/2023 “Për fondet private të pensioneve”, në datë 21.09.2023 i cili ka hyrë në fuqi më 06.11.2023, si dhe hartimi/miratimi nga AMF i akteve nënligjore, procesi i përputhshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe fondit të pensioneve sipas kërkesave të reja ligjore. do të kryhet brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Më 31 dhjetor 2024, Shoqëria ka të punësuar 14 punonjës dhe drejtues të lartë (2023: 13).

2. BAZAT E KONTABILITETIT

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet e Kontabilitetit (“SNRF”). Ato janë autorizuar për tu raportuar nga drejtimi i Shoqërisë me 27 Janar 2025.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, duke qënë se drejtimi është i kënaqur se Shoqëria ka burime të përshtatshme për të vazhduar si një entitet me vijueshmëri për të ardhmen e parashikueshme. Në kryerjen e këtij vlerësimi, drejtimi ka konsideruar një gamë të gjërë informacioni përshirë edhe projekte të fitueshmërisë, kërkesave të kapitalit rregullator dhe nevojave të financimit. Ky vlerësim përfshin gjithashtu edhe marrjen në konsideratë të skenareve ekonomik të mundshëm të përkeqësimit dhe impaktet e mundshme mbi fitueshmërinë, kapitalin dhe likuiditetet e Shoqërisë.

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë, përfshirë ndryshimet në to, janë të paraqitura në Shënimin 5.

3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL

Në përgatitjen e ketyre pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë ka kryer gjykime dhe të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet. Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në periudhat e ardhshme.

A. Gjykime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kane efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimin 5(b) – njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat nga tarifat e administrimit njihen përgjatë periudhës apo në një moment të caktuar në kohë.

- Shënimin 5(l), 12 – afati i qirasë; Nëse Shoqëria është në menyrë të arsyeshme e sigurt për të ushtruar opsionet e zgjatjes së afatit.

B. Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat në datën e raportimit kanë një rrezik domethënës duke rezultuar në një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 6.b (ii) – matja e HPK-ve për të arkëtueshmet nga fondet; supozime kyce në percaktimin e normës mesatare të ponderuar të humbjes;

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Shoqëria ka aplikuar në mënyrë konsistente politikat kontabël në vijim të të gjitha periudhat e raportuara në këto pasqyra financiare. Fondi ka aplikuar në mënyrë konsistente politikat kontabël në vijim të të gjitha periudhave të raportuara në këto pasqyra financiare. Gjithashtu, Fondi ka adoptuar Shpalosjen e Politikave Kontabël (Amendimet ndaj SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) duke filluar nga 1 Janari 2024. Amendimet kërkojnë shpalosjen e politikave kontabël që janë “materiale” dhe jo më “të rëndësishme”. Amendimet nuk kanë rezultuar në ndonjë ndryshim të vetë politikave kontabël dhe nuk kanë ndryshuar në mënyrë domethënëse informacionin mbi politikat kontabël.

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit aktual në fund të vitit. Aktivët jo monetare edhe detyrimet ,

Nuk kanë ndryshuar në mënyrë domethënëse informacionin mbi politikat kontabël.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të matur me vlerën e drejtë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Monedha EUR (e cila është monedha e huaj më e përdorshme që shoqëria përdor) u shkëmbye me 31 dhjetor 2024 me kurs këmbimi prej Lek 98.15 (31 dhjetor 2023: Lek 103.88).

(b) Të ardhura nga administrimi i fondeve

Të ardhurat nga administrimi i fondeve konsistojnë në tarifat e administrimit të përcaktuara në prospektin e fondeve. Shoqëria njihet të ardhurat përgjatë kohës, mbi bazë ditore. Tarifa e administrimit llogaritet në baza ditore, si prej 2% mbi vlerën neto të aseteve të Fondit të Pensionit. Tarifa e ndërprerjes së parakohshme, e paguar nga kontribuesit për tërheqje të hershme nga fondi i pensioneve, llogaritet si përqindje e vlerës neto të fondit të kontribuesit (duke përfshirë tatimin në burim) në ditën e tërheqjes sipas kërkesave të rregullores nr. 142, datë 28.08.2024 “Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga Fondi i Pensionit Privat”. Kjo përqindje varion nga 2 në 15% në varësi të kohës që kontribuesi ka investuar në fond. Nuk ka asnjë penalitet për tërheqjet nga fondi i investimit.

Natyra dhe koha e përmbushjes së detyrimeve të performancës, duke përfshirë kushtet e konsiderueshme të pagesës

Të ardhurat nga administrimi i fondeve njihen në baza ditore si një përqindje e përcaktuar e vlerës neto të aktivitetit për Fondet e Pensionit dhe Investimit si dhe në bazë mujore për Fondet Alternative.

(c) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

(ii) Kontributet shoqërore vullnetare

Shoqëria paguan kontribute shoqërore vullnetare për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

(në Lek)

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(d) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat dhe kostot financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- të ardhura nga interesi;
- shpenzime nga interesi;
- fitim ose humbje neto nga aktivet financiare me VDPFH;

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar deri në:

- vlerën kontabël bruto të aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Në përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, normës efektive e interesit aplikohet mbi vlerën kontabel bruto (për aktive të ndryshëm nga ata me kredit të zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit. Megjithatë, për aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar mbas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten mbi normën e interesit efektiv të koston të amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk është më me kredit të zhvlerësuar, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi kthehet mbi bazën bruto.

(e) Shpenzimi për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi fitimin ose humbjen e vitit duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose të cilat kanë hyrë në fuqi thelbësisht në datën e raportimit, dhe çdo sistemim i tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm për vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i Shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

(f) Aktivet Afatgjata Materiale

(i) Njohja dhe Matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhura ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentet kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(në Lek)

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(f) Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

(ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e mëtejshme kapitalizohet vetëm nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të nxjerrë nga përdorimi koston e një pajisje neto nga vlera mbetur e vlerësuar duke përdorur metodën e vlerës së mbetur dhe zakonisht njihet në fitime dhe humbje.

Normat e amortizimit vjetore janë si më poshtë:

- | | |
|--------------------------|-----|
| - Pajisje Zyre | 20% |
| - Instalime kompjuterike | 25% |

(g) Aktive të patrupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Aktivet e patrupëzuara që blehen nga Shoqëria dhe kanë jetë përdorimi të përcaktuar maten me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

(ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e mëtejshme kapitalizohet vetëm nëse është e mundshme që të rrisë përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në fitim ose humbje në periudhën që ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të nxjerrë nga përdorimi koston e një pajisje neto nga vlera mbetur e vlerësuar duke përdorur metodën e vlerës së mbetur dhe zakonisht njihet në fitime dhe humbje. Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e amortizimit vjetor është 25%.

(h) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Llogaritë e arkëtueshme dhe investimet në letrat me vlerë njihen fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit. Një aktiv financiar (përveç nëse është një kërkesë për arkëtim që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi) ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus ose minus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo një VDPFH. Një llogari e arkëtueshme pa një komponent financimi domethënës matet fillimisht me çmimin e transaksionit.

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëposhtme

Aktivët Financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur: me kosto të amortizuar; VDATGJ – investimet në letra me vlerë; VDATGJ – instrumenta të kapitalit; ose VDPFH.

Aktivët financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivët financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit

Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me VDPFH:

- aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale; dhe,

- kushtet kontraktuale të aktivit financiar gjenerojnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat përbëjnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar.

Një instrumenti borxhi matet me VDATGJ nëse ai plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH):

- aktivi mbahet në një model biznesi, objektivi i të cilit arrihet nëpërmjet arkëtimit të flukseve monetare kontraktuale dhe shitjes së aktiveve financiare;

- termat kontraktuale të aktivit financiar krijojnë flukse monetare në data të caktuara që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar.

Në njohjes fillestare të një investimi në instrumente të kapitalit neto i cili nuk mbahet për qëllime tregtimi, Shoqëria në mënyrë të përvokueshme mund të vendos të paraqesë ndryshimet në vijim me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Ky vendim merret rast pas rasti sipas investimeve.

Të gjitha aktivët e tjera financiare klasifikohen të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH). Kjo përfshinë edhe ndonjë aktiv financiar derivative. Gjithashtu, në fazën e njohjes fillestare, Shoqëria në mënyrë të përvokueshme mund të vendos që një aktiv financiar, i cili i plotëson kushtet të matet me kosto të amortizuar ose me VDATGJ, ta masë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse në këtë mënyrë eliminon ose zvogëlon ndjeshëm papajtueshmërinë kontabël që mund të rezultojë.

Aktivët financiare-Vlerësimi i modelit të biznesit

Shoqëria ka bërë një vlerësim të qëllimit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli sepse pasqyron më mirë mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe të paraqitjes së informacionit ndaj drejtimit. Informacioni që është marrë në konsideratë përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruar për portofolin dhe zbatimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhimit fokusohet tek gjenerimi i të ardhurave nga interesat kontraktual, ruajtja e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhja e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimi i flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;

- mënyrën e vlerësimit të ecurisë së portofolit dhe raportimit tek drejtimi i Shoqërisë;

- rreziqet që çenojnë ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktivët financiare që mbahen në këtë model biznesi) dhe strategjia për mënyrë e menaxhimit të këtyre rreziqeve

- si kompensohen drejtuesit e biznesit (p.sh. nëse kompensimi bazohet me vlerën e drejtë të aktiveve që menaxhohen ose fluksin e mjeteve monetare kontraktuale që arkëtohen); dhe

- periodicitetin, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për këto shitje, dhe pritshmëritë e saj për aktivitetin e shitjeve në të ardhmen.

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Shoqërisë.

Aktivitetet financiare që mbahen për qëllime tregtimi ose manaxhohen dhe ecuria e të cilave vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë, maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Aktivitetet financiare - Vlerësim nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit

Për qëllim të këtij vlerësimi, ‘principal’ është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. ‘Interesi’ është shpërblimi për vlerën në kohë të pasasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh, rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe - kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme).

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shumën e parapaguar në thelb paraqet shumën e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

(në Lek)

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Aktivët financiarë - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet:

Aktivët financiarë me VDPFH	Këto aktive maten më pas me vlerë të drejtë. Fitimet dhe humbjet neto, përfshirë ndonjë të ardhur nga interesi ose dividendi, njihen në fitim ose humbje.
Aktivët financiarë me koston e amortizuar	Këto aktive maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.
Investimet në letra me vlerë me VDATGJ	Këto aktive maten më pas me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Fitime dhe humbjet e tjera neto njihen në ATGJ. Në momentin e çregjistrimit, fitime ose humbje të akumuluarat në ATGJ riklasifikohen në fitim ose humbje.
Instrumentat e kapitalit me VDATGJ	Këto aktive maten më pas me vlerën e drejtë. Dividentet njihen si të ardhura në fitim ose humbje vetëm nëse dividendi qartësisht përfaqëson një rekuperim të koston së investimit. Fitime dhe humbjet e tjera neto njihen në ATGJ dhe kurrë nuk riklasifikohen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar ose me VDPFH. Një detyrim financiar klasifikohet si VDPFH nëse është i klasifikuar si i mbajtur për tregtim, është një derivativ ose është i krijuar si tillë që në njohjen fillestare. Detyrimet financiare me VDPFH maten me vlerë të drejtë dhe fitimet dhe humbjet neto, përfshirë ndonjë shpenzim nga interesi, njihen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare e tjera pas njohjes fillestare maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

(në Lek)

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi

Aktivet Financiare

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur:

të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose

kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrime financiare

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur kushtet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati. Gjithashtu, Shoqëria çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset monetare të tyre janë thelbësisht të ndryshme dhe në këtë rast njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar në kushtet e modifikuara.

Me çregjistrimin e detyrimit financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivit që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuara njihet në fitim ose humbje.

(iv) Kompesimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

(j) Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar paraqitet në vlerën e tij nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetimin, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në zerat e kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

(k) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiar jo-derivativ

Instrumentat financiare

Shoqëria njeh një zbritje për HPK për:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar
- titujt e borxhit të njohur me VDATGJ

Shoqëria njeh një zbritje për HPK për një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivit, përveç instrumenteve më poshtë për të cilat llogaritet HPK 12-mujore.

- titujt e borxhit të cilat vlerësohen të kenë një rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare, për të cilat rreziku i kredisë (rreziku i humbjes së pritshme që ndodh përgjatë jetës së instrumentit financiar) nuk është rritur ndjeshëm nga momenti i njohjes së tyre fillestare. Humbjet për llogaritë e arkëtueshme janë gjithmonë të matura për një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivit

(në Lek)

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(k) Zhvlerësimi (vazhdim)

(i) Aktivet financiar jo-derivativ (vazhdim)

Instrumentat financiare (vazhdim)

Në përcaktimin nëse rreziku i kredisë i një aktivi financiar është rritur në mënyrë domethënëse që nga njohja fillestare dhe kur vlerësohet HPK, Shoqëria merr në konsideratë informacion të mbështetur dhe të arsyeshëm që është relevant dhe disponibel pa patur kosto dhe perpjekje shtesë. Kjo përfshin informacion dhe analizë sasiore dhe cilësore, duke u bazuar në eksperiencën historike të Shoqërisë dhe vlerësime kredie të informuara që përfshijnë edhe informacione të ardhshme.

Shoqëria konsideron që rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë domethënëse nëse është më shumë se me 30 ditë vonesë pa paguar.

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

Shoqëria konsideron një investim në tituj me rrezik kredie të ulët kur niveli i rrezikut të kredisë është ekuivalente me çfarë kuptohet globalisht me përcaktimin “investment grade”. Shoqëria e konsideron këtë të jetë Baa3 ose më lart sipas Moody’s ose BBB- ose më lartë sipas Standard and Poor’s.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit (ose një periudhë me e shkurtër nëse jeta e pritshme e instrumentit është me pak se 12 muaj).

Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrëzikut të kredisë.

Matja e HPK

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t’i paguhen Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë). HPK janë skontuar me normen efektive të aktivitetit financiar.

Aktivitetet financiare të zhvlerësuara

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivitetet financiare të mbajtura me koston e amortizuar dhe instrumentat e borxhit me VDPFH janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse ka ndodhur një ose më tepër ngjarje që kanë ndikim të ndjeshëm në flukset monetare të ardhshme.

Të dhënat e verifikueshme që tregojnë se një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë:

- vështirësi të mëdha financiare të debitorit;
- shkelje të kontratës ose debitori është më tepër se 90 ditë me vonesë në kryerjen e pagesës;
- ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Shoqëria me kushte të cilat Shoqëria nuk do t’i konsideronte në një situatë tjetër);
- është e mundur që debitori do të falimentojë ose do të riorganizohet financiarisht.
- zhdukja e një tregu aktiv për një instrument financiar për shkak të vështirësive financiare.

Paraqitja e zbritjes për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar.

Humbjet për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve. Për letrat me vlerë me VDATGJ, humbja nga zhvlerësimi ngarkohet në fitim ose humbje dhe njihet në ATGJ.

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(I) Qiratë

Në fillimin e një kontrate, Shoqëria vlereson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata parashikon të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të percaktuar për një periudhë kohë në këmbim të një pagese.

(i) Si një qiramarrës

Në momentin e fillimit ose të modifikimit të një kontrate që përmban një përbërës qiraje, Shoqëria i cakton pagesën në kontratë, secilit përbërës të qirasë, në bazë të çmimeve përkatëse. Sidoqoftë, për marrjen me qira të zyrtare Shoqëria ka vendosur të mos ndajë përbërësit jo të qirasë dhe llogarit për përbërësit e qirasë and jo qirasë si një përbërës i vetëm i qirasë.

Shoqëria e njeh aktivin me të drejtë përdorimi dhe detyrimin e qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aktivin me të drejtë përdorimi matet fillimisht me kosto, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë, të rregulluar për të gjitha pagesat e qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte që është kryer dhe një çmuarje të kostove për çmontimin dhe heqjen e përmirësimeve ose për të sjellë në gjendjen fillestare aktivin ose ambientin në të cilin ndodhen, neto nga ndonjë incentive qiraje të marre.

Aktivin me të drejtë përdorim zhvleresohet më pas nëpërmjet përdorimit të metodës lineare, nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirase, vetëm nëse qiraja transferon pronesinë e aktivit në fjalë të Shoqërisë me perfundim të afatit të qirasë ose kosto e aktivit me të drejtë përdorimi reflekton faktin që Shoqëria do të ushtrojë një opsion blerjeje. Në këtë rast aktivin me të drejtë përdorimi do të zhvleresohet përgjatë jetës së përdorimit të aktivit në fjalë, i cili percaktohet me të njëjtën bazë si me ato të aktiveve afatgjata të trupezuara. Gjithashtu, aktivin me të drejtë përdorimi reduktohet për humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet për rimatjen e detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të cilat skontohej duke përdorur normën e interesit të përfshirë në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të percaktohet me lehtësi, normën rritëse të huamarrjes së bankës. Në përgjithësi, Shoqëria përdor normën rritëse të huamarrjes së bankës si normë interesi.

Shoqëria përcakton normën e saj rritëse të huamarrjes duke analizuar huamarrjet e saja nga burime financimi të ndryshme të jashtme dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar afatet e qirasë dhe llojin e aktivit të marrë me qira.

Pagesat e qirasë, që përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë, përbëhen nga sa më poshtë vijon:

- pagesa fikse, duke përfshirë pagesa fikse në substancë;
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, e cila matet fillimisht duke përdorur indeksin e normës në datën e fillimit;
- shumat që priten të paguhet në bazë të një garancie të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtuar sipas opsionit të blerjes që Shoqëria në mënyrë të arsyeshme është e sigurt për të ushtuar, pagesat e qirasë gjatë një periudhe rinovimi opsionale nëse Banka në mënyrë të arsyeshme vendos të ushtrojë opsionit për zgjatjen e afatit, dhe penalitetet për perfundimin e parakohshëm të afatit të qirasë, përveçse kur Banka në mënyrë të arsyeshme nuk është e sigurt për të zgjidhur kontratën para afatit.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ajo rimatet nëse ka një ndryshim në pagesat e qirasë në të ardhmen që rezultojnë nga ndryshimi i indeksit ose normës, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Shoqërisë për shumën që parashikohet të paguhet në bazë të garancisë të vlerës së mbetur, nëse Shoqëria ndryshon vlerësimin e saj në lidhje me ushtimin e opsionit të blerjes, zgjatjes së afatit ose perfundimit të kontrates ose nëse ka një pagesë të rishikuar të qirasë fikse në substancë.

(në Lek)

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(l) Qirate (vazhdim)

(i) Si një qiramarrës (vazhdim)

Kur detyrimi i qirasë matet në këtë mënyrë, në vlerën kontabël të aktivit me të drejtë përdorimi behet rregullimi përkatës, ose rregjistrohet në pasqyrën e fitim humjeve nëse vlera kontabël e aktivit me të drejtë përdorimi zvogëlohet në zero.

Shoqëria paraqet aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë në zera të vecantë financiarë të pasqyrës të pozicionit financiar

Qiratë afatshkurtra dhe aktivet me vlerë të vogël.

Shoqëria ka vendosur të mos njohë aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë, për qiratë e aktiveve me vlerë të vogël dhe qiratë afatshkurtra. Shoqëria njih pagesat e qirasë që shoqërohen me keto qira si shpenzime në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

(ii) Si një qiradhënës

Në momentin e fillimit ose modifikimit të një kontrate që përmban një përbërës qiraje, Shoqëria i cakton pagesën në kontratë secilit përbërës të qirasë në bazë të çmimit specifik.

Kur Shoqëria vepron si qiradhënës, në fillimin e qirasë përcakton nëse qiraja është një qira financiare ose një qira operative. Gjithashtu, Shoqëria nuk është e përfshirë në ndonjë transaksion ose aktivitet që do të mund të konsiderohej si qiradhënës.

(m) Matja e Vlerës së Drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim mund të shlyhet në një transaksion të zakonshëm midis palëve që kanë njohuri dhe mundësi të kryejnë një transaksion në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes në tregun kryesor, ose në mungesë të tij, në tregun më me shumë avantazhe në të cilin Shoqëria ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton edhe riskun e saj të mos-performancës.

Disa prej politikave kontabël dhe shënimeve të Shoqërisë kërkojnë matjen e vlerës së drejtë për aktivet financiare.

Kur është e mundshme, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe përfaqësojnë transaksione aktuale të tregut dhe që ndodhin rregullisht. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Shoqëria përllogarit vlerën e drejtë duke përdorur një metodë vlerësimi që maksimizon përdorimin e transaksioneve të ndodhura dhe minimizon përdorimin e të dhënave jo të vëzhgueshme. Metoda e zgjedhur e vlerësimit merr parasysh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit. Nëse një aktiv ose detyrim matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofruar dhe një çmim të kërkuar, Shoqëria mat aktivet dhe pozicionet afatgjatë me çmimin e kërkuar dhe detyrimet dhe pozicionin afatshkurtër me çmimin e ofruar.

Evidenca më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, që do të thotë vlera e drejtë e dhënë ose e marrë. Nëse Shoqëria përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk është e mundur të evidentohet nga vlera e drejtë të atij instrumenti nga krahasimi me transaksione të tjera të ndodhura në treg për aktive ose detyrime identike ose nuk mund të bazohet në metoda vlerësimi për të cilat të dhëna jo të vëzhgueshme në tregje gjykohen të jenë jo domethënëse në lidhje me matjen atëhere instrumenti financiar matet me vlerë të drejtë, i korrigjuar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin të transaksionit.

Me pas, çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi njihet më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se sa kur vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni është mbyllur.

5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(o) Standarde te reja por jo ne fuqi

Një sërë standardesh të reja janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2024 dhe lejohet zbatimi i mëhershëm; megjithatë, Kompania nuk i ka aplikuar më herët standardet e reja ose të ndryshuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

A. Standardet e Kontabilitetit (“SNRF”)

SNRF 18 do të zëvendësojë SNK 1 – Paraqitja dhe zbulimi në Pasqyrat Financiare edhe do të hyjë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më 1 janar 2027 ose më vonë. Ky standard i ri sjell disa kërkesa kryesore të reja:

- Entitetet janë të kushtëzuara të klasifikojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet duhet të klasifikohen në pesë kategori në pasqyrën e fitimit ose humbjes, specifikisht operacionale, investimi, financimi, operacionet e ndërprera dhe tatim mbi të ardhurat. Entitetet janë gjithashtu të kushtëzuara të prezantojnë një nën total të ri për fitimin operativ. Fitimi neto i entitetit nuk do të ndryshojë
- Masat e performancës të përcaktuara nga menaxhmenti do të shfaqen si një shënim i vetëm në pasqyrat financiare
- Udhëzime për të përmirësuar grupimin e informacionit në pasqyrat financiare nuk ofrohet

Të gjitha entitetet duhet të përdorin nën – totalin e fitimit operativ si pikënisje kur paraqesin flukset e parasë nga aktivitetet operative sipas metodës indirect.

Kompania është ende në process të vlerësimit të ndikimit të SNRF 18, vecanërisht në strukturën e pasqyrës së fitimit ose humbjes, pasqyrës së flukseve të parasë dhe kërkesave të reja për masat e performancës të përcaktuara. Gjithashtu, po analizohet ndikimi në mënyrën se si informacioni grupohet në pasqyrat financiare, përfshirë dhe arritkujt e etiketuar aktualisht si “të tjera”

B. Standarde të tjera kontabël

- *Mungesa e Shkëmbyeshmërisë*
- *Klasifikimi dhe matja e instrumentave financiare*
- *SNRF 19 (Filialet pa Kontabilitet Publik :Paraqitja*

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Shënime për pasqyrat financiare

(në Lek)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT

A. KLASIFIKIMI KONTABËL, VLERA E DREJTË DHE E MATJA E VLERËS SË DREJTË

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë sipas niveleve në hierarkine e vlerës së drejtë.

31 dhjetor 2024	Vlera Kontabël			Totali	Vlera e Drejtë			Totali
<i>Aktive financiare të matura me vlerë të drejtë</i>	Aktive Financiare me VDPFH	Aktive Financiare me kosto te amortizuar	Detyrime te tjera financiare		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
Investime në kuota	43,115,248	-	-	43,115,248	-	43,115,248	-	43,115,248
<i>Aktive financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>					-	-	-	
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre dhe depozita me afat	-	15,004,520	-	15,004,520	-	-	15,004,520	15,004,520
Investime në letra me vlerë	-	52,093,416	-	52,093,416		54,479,259		54,479,259
Të arkëtueshme nga fondet	-	8,140,553	-	8,140,553			8,140,553	8,140,553
Aktive te tjera	-	508,395	-	508,395			508,395	508,395
<i>Detyrime financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>								
Detyrime të tjera	-	-	(4,458,684)	(4,458,684)			(4,458,684)	(4,458,684)
	43,115,248	75,746,884	(4,458,684)	114,403,448	-	97,594,507	19,194,784	116,789,291
31 dhjetor 2023	Vlera Kontabël			Totali	Vlera e Drejtë			Totali
<i>Aktive financiare të matura me vlerë të drejtë</i>	Aktive Financiare me VDPFH	Aktive Financiare me kosto te amortizuar	Detyrime te tjera financiare		Aktive Financiare me VDPFH	Aktive Financiare me kosto te amortizuar	Detyrime te tjera financiare	
Investime në kuota	39,971,505	-	-	39,971,505	-	39,971,505	-	39,971,505
<i>Aktive financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>								
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre dhe depozita me afat	-	3,924,827	-	3,924,827	-	-	3,924,827	3,924,827
Investime në letra me vlerë	-	52,107,628	-	52,107,628	-	51,620,377	-	51,620,377
Të arkëtueshme nga fondet	-	6,460,300	-	6,460,300	-	-	6,460,300	6,460,300
Aktive te tjera	-	396,583	-	396,583	-	-	396,583	396,583
<i>Detyrime financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>								
Detyrime të tjera	-	-	(7,052,682)	(7,052,682)	-	-	(7,052,682)	(7,052,682)
	39,971,505	62,889,338	(7,052,682)	95,808,161	-	91,591,882	3,729,028	95,320,910

Aktivët financiarë të matura me vlerë të drejtë aplikojnë si teknike vlerësimi skontimin e fluksit të parasë. Vlera kontabel e aktiveve dhe detyrimeve financiare jo të matura me vlerë të drejtë janë një peraftrim i arsyeshëm i vlerave të drejta korresponduese.

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të rrezikut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e rrezikut. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve. Shoqëria gjatë aktivitetit të saj ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

Rreziku i kreditit

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i tregut

Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, si dhe politikat dhe procedurat për administrimin e këtyre rreziqeve.

i) Kuadri i Administrimit të Rrezikut

Sipas ligjit nr.76/2023, datë 21.09.2023 “Për fondet e pensionit private”, i ndryshuar dhe ligjit “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” nr. 56/2020, miratuar më 30.04.2020. Shoqëria Administruese duhet të ketë një funksion të vecantë për administrimin e rrezikut. Menaxheri i Riskut është përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe raporton tek Këshilli i Administrimit.

Politikat janë zhvilluar në bazë të strukturës së Fondit të Pensionit dhe Investimit dhe tolerancës së rrezikut të vendosur në politikën e investimeve. Skema e fondeve është e tillë që kontributet janë të përcaktuara, ndërsa përfitimet ngelen të pasigurta. Ndarja kryesore është që rreziku mbahet plotësisht nga klientët që kontribuojnë. Toleranca e rrezikut është elementi kryesor që përcakton diferencën midis fondeve nën administrim dhe që së bashku me skemën me kontribute të përcaktuara të fondit, qëndrojnë në thelb të zhvillimit të politikës së menaxhimit të rrezikut. Për të menaxhuar rrezikun e tregut financiar, Shoqëria ndërmerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuar të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sadoherë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuara, apo dhe menaxhimin e pozicioneve me anë të kontratave derivative. Shoqëria mund të përdorë kontratat derivative për fondet vetëm për qëllime eliminimi të risqeve dhe jo për qëllime fitimi nëpërmjet spekulimit.

ii) Rreziku i Kreditit

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Shoqëria konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku individual dhe rreziku i sektorit).

Këshilli i Administrimit të Shoqërisë ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë tek Drejtimi, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Shoqërisë. Investimet e Shoqërisë janë në bonot e thesarit dhe obligacionet e Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Shoqëria është e ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kredisë së Qeverisë Shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	15,004,520	3,924,827
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	43,115,248	39,971,505
Investime në letra me vlerë me KA	52,093,416	52,107,628
Të arkëtueshme nga Fondet	8,140,553	6,460,300
Të tjera aktive financiare	508,395	396,583
	118,862,132	102,860,843

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

ii) Rreziku i Kreditit (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare në datën e raportimit sipas llojit të rajonit gjeografik ishte:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Brenda Vendit	118,862,132	102,860,843
	118,862,132	102,860,843

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

31 dhjetor 2024	Stage 1	TOTAL
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	15,004,520	15,004,520
Letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizueshme	43,115,248	43,115,248
Letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizueshme	52,093,416	52,093,416
Të arkëtueshme nga Fondet	8,140,553	8,140,553
Aktive të tjera	508,395	508,395
Vlera kontabël	118,862,132	118,862,132
	Stage 1	TOTAL
31 dhjetor 2023		
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	3,924,827	3,924,827
Letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizueshme	39,971,505	39,971,505
Letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizueshme	52,107,628	52,107,628
Të arkëtueshme nga Fondet	6,460,300	6,460,300
Aktive të tjera	396,583	396,583
Vlera kontabël	102,860,843	102,860,843

Investimet e letrave me vlerë

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare në monedhën vendase në periudhën më të afërt. Qeveria shqiptare është vlerësuar si BB-, me perspektivë pozitive, bazuar në vlerësimin e kredive të Standard & Poor's dhe Ba3, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin e kredive të Moody's. Në aplikimin fillestar të SNRF 9, për shkak se nuk ka histori dështimi, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë zhvlerësim në 1 janar 2018 dhe shuma e saj nuk ka ndryshuar deri në fund vitin 2024.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe Depozitat me afat

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria aplikon një bazë humbjeje të pritshme 12-mujore dhe reflekton maturitetet afatshkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të saj dhe depozitave me afat. Në aplikimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë zhvlerësim në 1 janar 2018 dhe shuma e saj nuk ka ndryshuar deri në fund vitin 2024.

Të arkëtueshme nga Fondet

Normat e humbjeve bazohen ne pervojën reale te humbjeve nga kredia gjate 5 viteve te fundit. Kto norma shumezohen me faktore shkallezues per te pasqyruar ndryshimet midis kushteve ekonomike gjate periudhes ne te cilen jane mbledhur te dhenat historike, kushteve aktuale dhe vleresimit te Shoqerise per kushtet ekonomike gjate jetes se pritur te te arketueshmeve. Faktoret shkallezues bazohen ne rritjen faktike dhe te parashikuar te pagave mesatare bruto ne Shqiperi. Ne aplikimin fillestar te SNRF 9, per shkak te mbledhjes mujore te perseritur te ketyre te arketueshme, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë zhvlerësim në 1 janar 2018 dhe shuma e saj nuk ka ndryshuar deri në fund vitin 2024.

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

ii) Rreziku i Kreditit (vazhdim)

Në tabelën e mëposhtme jepen informacione për ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë dhe HPK më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 për shumat e arkëtueshme nga Fondet

	Mesatarja e ponderuar e raportit të humbjes	Vlera Kontabel Bruto	Humbje nga zhvlerësimi	Zhvlerësim I kredisë
31 dhjetor 2024				
Pa vonesa	0%	8,140,553	-	No
		8,140,553	-	
31 dhjetor 2023				
Pa vonesa	0%	6,460,300	-	No
		6,460,300	-	

Normat e humbjeve në llogaritë e arkëtueshme nga fondi bazohen në përvojën aktuale të humbjes së kredisë gjatë pesë viteve të fundit dhe konsiderohen jo të rëndësishme, pasi mbliidhen rregullisht brenda 30 ditëve të ardhshme.

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlllogaritjen e zhvlerësimit.

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Shoqëria konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Shoqëria konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, kur një ose më shumë nga kriteret sasiore, cilësore ose kriteret mbështetëse në vijim janë plotësuar. Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Shoqërisë.

Shoqëria monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë me ditëvonesa.

Përkufizimi i dështimit

Shoqëria konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Shoqërisë, pa qenë nevoja për veprime nga Shoqëria të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Shoqërisë.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Shoqëria konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës;

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

ii) Rreziku i Kreditit (vazhdim)

Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 5.m.

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

— PD-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; dhe

— PD-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

Matje e HPK

Të arkëtueshme nga Fondet

Shoqëria përdor matricën e zbritjeve për të matur HPK nga të arkëtueshmet nga fondet. Normat e humbjeve llogariten duke përdorur metodën e ‘normave të transferimit’ bazuar në probabilitetin e të arkëtueshmes që kalon fazat e njëpasnjëshme të mundësisë për të mos u shlyer. Normat e kalimit llogariten veçmas për ekspozime në segmente të ndryshme bazuar në karakteristikat e mëposhtme të përbashkëta të rrezikut të kredisë.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e me to dhe Depozitat me Afat

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria aplikon një bazë humbjeje të pritshme 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit. Në aplikimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë zhvlerësim në 1 janar 2018 dhe shuma e saj nuk ka ndryshuar deri në fund vitin 2024.

Investimet e letrave me vlerë

Të dhënat kryesore në matjen e HPK janë strukturat e parametrave të mëposhtëm: - probabiliteti i dështimit (PD); - humbja nga dështimi (HND); - ekspozimi në rast dështimi (END). Vlerësimet e PD janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten në bazë të të dhënave të mbledhura brenda dhe jashtë, që përbëjnë faktorë sasiore dhe cilësorë. HND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një zhvlerësim dhe vlerësohet bazuar në parametrat e llogaritur nga agjencitë e vlerësimit. END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një dështimi. Shoqëria nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës duke përfshirë amortizimin. END i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto. Vlerësimet e END janë llogaritur në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës. Shoqëria mat HPK duke marrë në konsideratë rrezikun e vonësës për periudhën maksimale kontraktuale mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse, për qëllime të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Shoqëria ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, Shoqëria nuk kishte aktive financiare me risk krediti të zhvlerësuar.

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga kapitali që i takon zotëruesve të kapitalit të Shoqërisë, duke përfshirë kapitalin, rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Shoqëria menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që nivelet e mjaftueshme të kapitalit të mirëmbahen për të qenë në gjendje të vazhdojnë biznesin si dhe të jenë në përputhje me kërkesat e kapitalit të rregullatorëve, duke maksimizuar kthimin e palëve të interesuara. Minimumi i kapitalit të kërkuar të përcaktuar me nenin 13 të ligjit nr. 56/2020 datë 30 Prill 2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe ligjit 76/2023 "Për fondet e pensionit private" është Lek 15,800,000. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, Shoqëria ka përmblusur të gjitha kërkesat për kapital.

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Shënime për pasqyrat financiare

(në Lek)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare që shlyhen duke dhënë hua ose ndonjë aktiv financiar tjetër. Politika e Shoqërisë është të investojë në letra me vlerë që do të mbahen deri në maturim.

31 dhjetor 2024	Vlera kontabël	Flukset monetare	Deri 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	15,004,520	15,004,520	15,004,520	-	-	-	-	-
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	43,115,248	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të mbajtura me KA	52,093,416	52,093,416	953,650	450,000	-	-	18,450,000	32,239,766
Të arkëtueshme nga Fondet	8,140,553	8,140,553	8,140,553	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	508,395	508,395	508,395	-	-	-	-	-
Tatim fitimi I parapaguar	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali aktivitet	118,862,132	75,746,884	24,607,118	450,000	-	-	18,450,000	32,239,766
Detyrime te tjera	4,458,684	4,458,684	4,458,684	-	-	-	-	-
Detyrime qera financiare	6,608,832	6,608,832	250,283	750,848	750,848	1,501,695	2,753,108	-
Interesa te detyrimit qerese financiare	-	-	-	107,474	93,635	144,771	112,087	-
Totali detyrimeve	11,067,516	11,067,516	4,708,967	858,322	844,483	1,646,466	2,865,195	-
Pozicioni neto	107,794,616	64,679,368	19,898,151	(408,322)	(844,483)	(1,646,466)	15,584,805	32,239,766
Efekti akumuluar			19,898,151	19,489,829	18,645,346	16,998,880	32,583,685	64,823,451

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Shënime për pasqyrat financiare

(në Lek)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

iii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2023	Vlera kontabël	Flukset monetare	Deri 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	3,924,827	3,924,827	3,924,827	-	-	-	-	-
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	39,971,505	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të mbajtura me KA	52,107,628	52,107,628	953,650	450,000	-	-	18,450,000	32,253,978
Të arkëtueshme nga Fondet	6,460,300	6,460,300	6,460,300	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	396,583	396,583	396,583	-	-	-	-	-
Tatim fitimi I parapaguar	273,687	273,687	-	-	273,687	-	-	-
Totali aktivitet	103,134,530	63,163,025	11,735,360	450,000	273,687	-	18,450,000	32,253,978
Detyrime të tjera	7,052,682	7,052,682	7,052,682	-	-	-	-	-
Detyrime qera financiare	7,048,207	7,048,207	327,974	647,037	948,281	1,816,386	3,308,528	-
Interesa të detyrimit qerash financiare	-	431,151	-	101,418	88,263	136,227	105,243	-
Totali detyrimeve	14,100,889	14,532,040	7,380,656	748,455	1,036,544	1,952,613	3,413,771	-
Pozicioni neto	89,033,641	48,630,985	4,354,704	(298,455)	(762,857)	(1,952,613)	15,036,229	32,253,978
Efekti akumuluar			4,354,704	4,056,249	3,293,392	1,340,779	16,377,008	48,630,986

(në Lek)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

iv) Rreziku i tregut

Ekspozimet në kurset e këmbimit valutor

Ekspozimet në valutë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjeve të pafavorshme në kurset e këmbimit valutor. Aktive financiare ose detyrime financiare në monedha të huaja më 31 dhjetor 2024 janë si më vijon:

Aktiv	LEK	EUR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14,563,892	440,628	15,004,520
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	43,115,248	-	43,115,248
Të arkëtueshme nga Fondet	52,093,416	-	52,093,416
Aktive të tjera	8,140,553	-	8,140,553
Investime në letra me vlerë KA	508,395	-	508,395
Totali aktiveve	118,421,504	440,628	118,862,132
Detyrime të tjera	4,149,511	309,173	4,458,684
Detyrime qiraje	-	6,608,832	6,608,832
Totali detyrimeve	4,149,511	6,918,005	11,067,516
Ekspozimi neto	114,271,993	(6,477,377)	107,794,616

Aktive financiare ose detyrime financiare në monedha të huaja më 31 dhjetor 2023 janë si më vijon:

Aktiv	LEK	EUR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3,546,346	378,481	3,924,827
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	39,971,505	-	39,971,505
Depozita me afat	6,460,300	-	6,460,300
Të arkëtueshme nga Fondet		396,583	396,583
Aktive të tjera	52,107,628	-	52,107,628
Investime në letra me vlerë KA	102,085,779	775,064	102,860,843
Totali aktiveve			
Detyrime të tjera	6,139,915	912,767	7,052,682
Detyrime qiraje	-	7,048,207	7,048,207
Totali detyrimeve	6,139,915	7,960,974	14,100,889
Ekspozimi neto	95,945,864	(7,185,910)	88,759,954

Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të instrumenteve të saj financiarë të luhaten si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset e mjeteve monetare. Periudha për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon pra në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

v) Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë që del nga një shumëllojshmëri e shkaqeve të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Shoqërisë, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kreditit, tregut dhe likuiditetit të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullative dhe standardet përgjithësisht të pranura të sjelljes së korporatave përjashtuar reputacionin dhe rrezikun strategjik.

Qëllimi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia primare për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Keshillit të Administrimit. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- Ndarja e duhur e detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- pajtimin dhe monitorimin e transaksioneve;
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- dokumentimin e kontrolleve dhe procedurave;
- vlerësimi periodik i rreziqeve operationale, përshtatshmëria e kontrolleve dhe procedurat e lidhura me to;
- raportimi i humbjeve operationale dhe veprimi i propozuar korrigjues;
- zhvillimi i planeve të emergjencës;
- trajnimi dhe zhvillimi profesional standardet etike dhe të biznesit;
- zbutjen e riskut, duke përfshirë sigurimin aty ku kjo masë është efektive.

7. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË TË TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre janë të përbërë si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari rrjedhëse në Lek	14,563,892	3,546,346
Llogari rrjedhëse në EUR	440,628	378,481
	15,004,520	3,924,827

8. KUOTA NË FOND INVESTIMI TË MBAJTURA ME VDPFH

Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kuota në fond investimi	43,115,248	39,971,505
	43,115,248	39,971,505

Në dhjetor 31 2024, gjendja në Fondin e investimi Credins Premium është 43,115,248 lek, me një total numër kuotash 30,796.9706 dhe çmim kuote 1,399.9834 lek/kuotë (2023: Gjatë vitit 2023, u blenë 7,679.5868 kuota me vlerë nominale Lek 10 milion u blenë me cmimin 1,302.1534 lek/kuote dhe 23,117.3838 kuota me vlerë nominale 30 milion, u blenë me cmimin 1,297.7247 lek/kuotë. Më 31 dhjetor 2023 gjendja në Fondin e investimi Credins Premium është 39,971,505 Lek; numri total i kuotave 30,796.9706 me çmim kuote prej 1,297.9038 lek/kuotë).

Fondi investon kryesisht në mjete monetare, depozita bankare dhe tituj borxhi me të ardhura fikse të Qeverisë Shqiptare, me profil rreziku të ulët (niveli 2 sipas prospektit të Fondit) dhe aktivet e Fondit vlerësohen me vlerë të drejtë me bazë ditore dhe çmimi i kuotës publikohet çdo ditë. Investimi në Fond konsiderohet me likuiditet të lartë pasi tërheqja e kuotave ndodh brenda 7 ditëve nga data e kërkesës

9. INVESTIME NË TITUJ ME KOSTO TË AMORTIZUAR

Investime në tituj me kosto të amortizuar më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Letra me vlerë (Bono dhe Obligacione Qeveritare) (vlera nominale)	51,000,000	51,000,000
Skonto	(62,156)	(47,944)
Interes i përlllogaritur	1,155,572	1,155,572
	52,093,416	52,107,628

Maturimi i mbetur i letrave me vlerë varion 3-10 vjet dhe me norma interesi që variojnë nga 5% në 6.25% me vlera nominale prej Lek 18, 10, 6, dhe 17 milion përkatësisht. Investimet në letrat me vlerë të maturuara me kosto të amortizuar nuk janë as të zhvlerësuar as të provigjionuara. (2023: 3- 10 vite për letrat me vlerë normat e interesit varjojnë nga 5 % të 6.25% me vlera nominale në Lek 18, 10, 6, and 17 milion).

10. TË ARKËTUESHME NGA FONDET

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga Fondi i Pensioneve	593,442	3,455,745
Të arkëtueshme nga Fondet e Investimeve Alternative	4,230,069	2,474,944
Të arkëtueshme nga Fondi i Investimeve	3,317,042	529,611
	8,140,553	6,460,300

Të arkëtueshme nga Fondet lidhen me tarifat e administrimit për muajin dhjetor për secilin nga fondet nën administrim si dhe me penalitetet e aplikuara mbi tërheqjet e parakohshme.

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Shënime për pasqyrat financiare

(në Lek)

11. AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI

Aktive me të drejtë përdorimi janë të përbëra si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Gjendja më 1 janar	7,974,541	4,556,170
Shtesa	2,786,410	7,405,643
Totali	10,760,951	11,961,813
Shpenzimi amortizimit për aktivin me të drejtë përdorimi	3,586,984	3,987,272
Gjendja në fund	7,173,967	7,974,541

Aktive me të drejtë përdorimi përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktivit në lidhje me një kontratë qiraje të lidhur me 7 Janar 2019 për zyrat dhe me një afat një vjeçar por që përfshin edhe një opsion për zgjatje afati midis të dy paleve prej 3 muaj para përfundimit të afatit të kontratës të pa-anullueshme. Shoqëria rishikon në fund të çdo periudhe raportuese të mëparshme nëse është në menyrë të arsyeshme e sigurt që opsioni për zgjatje afati do të ushtrohet nga të dy palët dhe korrigjon përkatësisht parashikimin për afatin e qirasë si dhe aktivet dhe detyrimet korresponduese për periudhën e raportimit në vijim. Më 31 dhjetor 2024, Drejtimi i Shoqërisë ka njohur një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim qiraje për periudhën e mbetur të 2 viteve (i.e 31 dhjetor 2026) të njohur plotësisht si detyrim afatshkurtër. Detyrimi i qirasë përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Gjendja më 1 janar	7,048,208	4,060,775
Shtesat	622,672	7,215,658
Shpenzimet e interesit	(516,951)	558,794
Fitim/humbje nga këmbimi	(3,634,561)	(859,928)
Këstet e qirasë	3,089,464	(3,927,092)
Gjendja më 31 dhjetor	6,608,832	7,048,207

Shpenzimi i amortizimit i aktivit me të drejtë përdorimi është përlogaritur dhe paraqitur në fitim ose humbje. Interesi mbi detyrimin e qirasë njohur në fitim ose humbje është në shumën Lek 516,951 (2023: Lek 558,794) ndërsa shumat e njohura në pasqyrën e flukseve monetare në lidhje me flukset monetare dalëse për qiranë janë në shumën Lek 4,151,512 (2023: Lek 4,787,019).

12. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË PATRUPEZUARA

Aktive të qëndrueshme të patrupezuara janë të përbëra si vijon:

	Software	Totali
Kosto		
Më 31 dhjetor 2023	10,762,402	10,762,402
Shtesa	1,121,062	1,121,062
 Pakësime		
Më 31 dhjetor 2024	11,883,464	11,883,464
Zhvlerësimi i akumuluar		
Më 31 dhjetor 2023	(9,234,611)	(9,234,611)
Zhvlerësimi i vitit	381,948	381,948
Nxjerrje nga përdorimi	-	-
Më 31 dhjetor 2024	9,616,559	9,616,559
Vlera Kontabël		
Më 31 dhjetor 2023	1,527,791	1,527,791
Më 31 dhjetor 2024	2,266,905	2,266,905

Shoqëria Administruese “Credins Invest” Sh.a
Shënime për pasqyrat financiare

(në Lek)

13. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPEZUARA

Aktive të qëndrueshme të trupezuara janë të përbëra si vijon:

	Pajisje zyre	Instalime kompjuterike	Totali
Kosto			
Më 31 dhjetor 2023	4,409,398	12,707,297	17,116,695
Shtesa	-	248,400	248,400
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	4,409,398	12,955,697	17,365,095
Amortizimi i akumuluar			
Më 31 dhjetor 2023	3,014,227	6,478,971	9,493,198
Amortizimi i vitit			
Nxjerrje nga përdorimi	279,036	1,453,133	1,732,169
Më 31 dhjetor 2024	3,293,263	7,932,104	11,225,367
Vlera Kontabël			
Më 31 dhjetor 2023	1,395,171	6,228,326	7,623,497
Më 31 dhjetor 2024	1,116,135	5,023,593	6,139,728

14. AKTIVET E TJERA

Aktivitet e tjera janë të përbëra si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
TVSH e arkëtueshme	4,550	-
Parapagime për sigurim jete dhe shëndeti – stafi	407,572	396,583
Të arkëtueshme nga punonjësit	96,273	-
Totali	508,395	396,583

15. DETYRIMET E TJERA

Detyrimet e tjera janë të përbëra si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime për taksa, TVSH, dhe sigurime shoqërore	2,227,197	1,319,687
Shërbime profesionale	737,980	466,712
Furnitorë	901,085	4,988,202
Shpenzime të përllogaritura	-	21,720
Detyrim ndaj Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare	311,829	256,361
Të pagueshme ndaj personelit	280,593	-
Total	4,458,684	7,052,682

Me 31 dhjetor 2024, Shoqëria ka pasur një detyrim tatimor prej 728,460 lekë (2023: Lek 273,687) për shkak të paragimit tatimor. Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat gjatë vitit 2024 është 2,242,424 Lek (2023: Lek 1,461,208), ndërkohë shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat vjetore është 3,244,572 Lek (2023: 2,530,071 Lek).

(në Lek)

16. KAPITALI AKSIONAR

Struktura aksionare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është si vijon:

	31 dhjetor 2024				31 dhjetor 2023		
	%	Nr i aksioneve	Ekuivalent në Lek	%	Nr i aksioneve	Ekuivalent në Lek	
CREDINS Bank	76%	177,623	72,825,018	76%	177,622	72,825,019	
SiCRED Sh.a.	0%	-	-	12%	28,046	11,498,687	
Estela Koçi	8%	18,697	7,665,791	5%	11,685	4,791,120	
Genc Koxhaj	6.8%	15,892	6,515,921	3,5%	8,180	3,353,784	
Egi Santo	6.8%	15,892	6,515,921	3,5%	8,180	3,353,784	
Armira Citozi	1.4%	3,272	1,341,512	-	-	-	
Vjosa Bodo	1%	2,337	958,231	-	-	-	
	100%	233,713	95,822,394	100%	233,713	95,822,394	

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, aksionet e kapitalit të regjistruar kanë një vlerë nominale prej Lek 410. Në 24 Shtator 2024, Asambleja e Aksionarëve aprovoi ndryshimin në strukturën e aksionerëve. SiCRED Sha shiti të gjitha aksionet me një numër aksionesh prej 28,046, të cilat u blenë nga 3 aksionerë egzistues dhe 2 aksionerë të rinj. Ky ndryshim u aprovua nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (vendimi nr 208), më 24 Dhjetor 2024 dhe u regjistrua në QKB në 7 Janar 2025.

Rezerva ligjore është krijuar në përputhje me kërkesat e ligjit të shoqërive tregtare ku kërkohet të transferohet minimalisht pesë përqind të fitimit neto vjetor, mbas zbritjeve të humbjeve të mbartura, derisa kjo rezervë të barazojë një të dhjetën e kapitalit të nënshkruar

Me datë 08.04.2024 (2023: 01.06.2023), Asambleja Aksionarëve miratoi shpërndarjen e rezultatit të vitit 2023. Vlera Lek 13,335,203 (2023: Lek 10,724,040) ka kaluar në zërin humbje të mbartura, ndërsa dividend nuk është paguar (2023: Lek 2,681,01 shpërndarje dividenti)

17. TARIFA NGA ADMINISTRIMI FONDEVE

Tarifa nga administrimi i Fondeve është e përbërë si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fondi i Investimit	6,464,765	7,186,222
Fondi i Pensionit	45,428,772	37,193,980
Fondet Alternative të Investimit	19,447,836	17,490,804
	71,341,373	61,871,006

Tarifat e administrimit janë llogaritur në bazë ditore me një tarifë prej 2% dhe 1% mbi vlerën neto të aseteve të Fondit të Pensioneve dhe Fondit të Investimit, perkatesisht. Tarifa e administrimit të fondeve të investimit alternative Sea Land dhe Green View janë llogaritur me një tarifë prej 0.35% mbi vlerën totale të aseteve të Fondeve.

18. TARIFA NGA TËRHEQJET E PARAKOHSHME

Tarifa nga tërheqjet e parakohshme janë të përbëra si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fondi pensionit	3,171,481	5,398,475
	3,171,481	5,398,475

Tarifa për tërheqje të parakohshme, paguar nga kontribuesit për tërheqjen e parakohshme të kontributeve është llogaritur si përqindje e vlerës së fondit të kontribuesit neto (duke përjashtuar tatimin në burim) në ditën e tërheqjes. Kjo përqindje varion nga 2 deri në 15%, në varësi të periudhës që kontribuesi ka investuar në fond. Nuk ka tarifa për tërheqje të parakohshme për Fondet e tjera nën administrimin e Shoqërisë.

19. TË ARDHURA/(SHPENZIME) INTERESI, NETO

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Interesi i letrave me vlere	2,807,300	3,560,656
Interesi nga depozitat	1,106	127
Amortizimi i primit/diskountit	(18,799)	(6,181)
Shpenzime interesi qiraje	(622,672)	(558,794)
	2,166,935	2,995,808

20. FITIM /HUMBJE NGA INVESTIMET NË KUOTA

Fitimi nga investimi në kuota përbëhet nga fitimi i përealizuar i kuotave gjendje më 31.12.2024 (shenimi 8).(2023: Humbja nga investimi në kuota përbëhet nga humbja e përealizuar e kuotave më 31 dhjetor 2023).

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitim/ (Humbje) interesi, neto nga fondi investimeve	3,143,743	28,495
	3,143,743	28,495

21. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet personeli janë të përbëra si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Paga dhe shpërblime	32,341,008	30,648,179
Sigurime shoqërore	3,949,325	3,810,801
Skemë Pension Privat	675,000	680,500
Sigurim jete dhe shëndeti	284,145	336,041
	37,249,478	35,475,521

22. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative janë të përbëra si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Mirëmbajtje programe kompjuterik	3,417,889	2,866,572
Tarifë depozitari FP	2,969,965	2,510,594
Asistencë nga Palë të treta	1,134,581	1,113,634
Siguracione	1,352,100	1,072,705
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	1,201,455	1,050,292
Shpenzime te tjera	1,145,189	901,583
Shërbime profesionale	1,097,980	890,942
Tarifa Keshilli Administrimi	1,080,000	808,355
Marketing	684,548	760,000
Energji	609,051	563,821
Shpenzime pritje	644,846	546,699
Shpenzime postare dhe telefonike	275,052	427,951
Taksa vendore dhe tarifa regjistrimi	510,920	371,980
Kancelari	261,969	193,660
Komisione bankare	144,641	154,651
Komision agjenti Fondi i investimit	80,005	26,718
	<u>16,610,191</u>	<u>14,260,157</u>

23. SHPENZIMI PËR TATIM FITIMI

Një rakordim i shpenzimit të tatim fitimit për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitimi i periudhes	20,460,317	15,865,274
Shpenzimet e pazbritshme	1,170,163	1,001,868
Fitimi para tatimit	<u>21,630,481</u>	<u>16,867,142</u>
Tatim fitimi sipas normës së përqindjes vendore	<u>3,244,572</u>	<u>2,530,071</u>

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2024 është 15% (2023: 15%). Deklaratat tatimore janë plotësuar për çdo vit por fitim-humbjet e deklaruar për qëllime tatimore mbeten si parashikime derisa autoritetet tatimore kontrollojnë ato dhe regjistrimet e taksapaguesit dhe lëshohet një vlerësim final. Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritet tatimore. Shpenzimet e pazbritshme për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura për efekte fiskale.

24. ANGAZHIME DHE KONTIGJENCA

Ne nje vije normale biznesi, kompania perballlet me pretendime ligjore qe nuk jan te lidhura me veprimtarine kryesoe te biznesit. Administrimi i kompanise eshte e mendimit qe nuk do te kete humbje materiale ne lidhje me asnje nga kto pretendime ligjore te hapura me 31 dhjetor 2024

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndermarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivitet		
Banka CREDINS sh.a.	7,625,716	3,590,366
Fondi Investimeve “Credins Premium”	593,442	529,611
Fondi Pensionit “Credins Pension”	4,230,069	3,455,745
Fondi i Investimeve Alternative “Green View”	1,472,931	933,998
Fondi i Investimeve Alternative “Sea Land”	1,844,110	1,540,946
Detyrimet		
SiCRED shoqëri sigurimi jete	149,036	555,783
Shpenzimet	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Banka CREDINS sh.a.	791,225	1,044,157
SiCRED shoqëri sigurimi jete	36,722	1,386,333
Sicred Assistance	162,000	162,000
Shpërblimet e drejtimit	9,540,000	8,690,000
Te ardhurat		
Fondi Investimeve “Credins Premium”	6,464,765	7,186,222
Fondi Pensionit “Credins Pension”	45,428,772	37,193,980
Fondi Pensionit “Credins Pension”	3,171,481	5,398,475
Fondi i Investimeve Alternative “Green View”	7,760,314	6,810,812
Fondi i Investimeve Alternative “Sea Land”	11,687,522	10,679,992

26. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës raportuese që kërkojnë rregullim ose dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.